



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Qershor 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e radhës pasqyrohen aktivitetet për muajin qershor 2021)

Reformimi i administratës së sistemit prokurorial, fokus i takimit të Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurori Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës.

Pikë kryesore e rendit të ditës e këtij Komisioni ishte iniciativa për hartimin Konceptdokumentit për reformimin e administratës së sistemit prokurorial.



Administrata e sistemit prokurorial deri me tani ka qenë e rregulluar në bazë të katër rregulloreve, ndërsa qëllimi i kësaj reforme është unifikimi i rregullimit të administratës, reforme që do të bëhet edhe duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Po ashtu, qëllim tjetër i reformës së administratës është fuqizimi i kapaciteteve profesionale, me synim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësve që administratës i takojnë.

Diskutohen ndryshimet buxhetore për vitin 2021

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, nën udhëheqjen e Ariana Shajkocit, kryesuese, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin janë diskutuar dy pikat e parapara me agjendë.

Anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel shqyrtuan dhe aprovuan ndryshimet buxhetore për vitin 2021.



Po ashtu, gjatë këtij takimi u diskutuan nevojat e identifikuar për kërkesën buxhetore 2022-2024, me fokus të veçantë kërkesat për staf shtesë dhe projektet kapitale për këtë periudhë.

Zëvendësimi i regjistrave manualë me elektronikë, temë diskutimi e Zëvendëskryesuesit të KPK-së me Kryeprokurorin e Ferizajt

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, njëherësh Kryesuesi i Komisionit për Administrim të Prokurorive, Veton Shabani, i shoqëruar nga zëvendësmenaxheri i Projektit TIK-SMIL, Nexhat Haziri, mbajti takimin e dytë me radhë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Shukri Jashari, lidhur me largimin e regjistrave manualë në kuadër të digjitalizimit të procesit të punës, me ç'rast faza e pilotimit të këtij projekti ka filluar të zbatohet në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.



Takime u zhvilluan edhe me zyrtarët përgjegjës për regjistrimin e lëndëve dhe përdorimin e SMIL-it ku u diskutua lidhur me progresin në heqjen e regjistrave manual dhe zëvendësimin me ata elektronik për fazën

e parë të këtij pilot projekti që ka filluar me regjistrat PPN.

Fillon takimi vjetor i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të KE-së

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Veton Shabani, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, prokurorë të prokurorive të vendit, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të SKPK-së, Valdrin Krasniqi, si dhe përfaqësues të tjerë të KPK-së, morën pjesë përmes videokonferencës në takimin vjetor të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të Komisionit Evropian, i cili mbështetet nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Në këtë takim, i cili vijoi dy ditë me radhë, është diskutuar për Strategjinë e sektorit të sundimit të ligjit, funksionimin e Këshillit Prokurorial dhe mekanizmeve të tij llogaridhënës, sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve dhe regjistrat e të dhënave, progresin në zbatimin e rekomandimeve për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe raportin final për zbatimin e konkluzioneve të takimit të vitit të kaluar të këtij nënkomiteti, që ndërlidhet me sistemin prokurorial.



Gjithashtu, në takimin e sotëm morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë, zyrtarë të Komisionit Evropian dhe zyrtarë të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Ndërkaq, pas përfundimit të të gjitha takimeve, Komisioni Evropian do të hartojë konkluzionet e reja, që dalin si rezultat i takimeve të mbajtura dhe ato që pritet të përmbushen dhe prezantohen në takimin e radhës.

Kryesuesi Maloku ka vizituar Prokurorinë e Apelit dhe atë Themelore të Prishtinës

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, vizitoi Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore të Prishtinës, me ç'rast takoi dy kryeprokurorët e këtyre prokurorive, Xhevdet Bislimi dhe Kujtim Munishi.

Gjatë këtyre vizitave, Kryesuesi Maloku është njoftuar nga dy kryeprokurorët me organizimin, punët, angazhimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këto prokurori.

Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit ka thënë së prioritet i tij është shtimi i numrit të prokurorëve dhe stafit administrativ në këtë prokurori.



Ndërkaq, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Kujtim Munishi, theksoi se në këtë prokurori është duke u bërë punë e madhe nga të gjithë prokurorët dhe stafi administrativ, si dhe ka cekur se prioritet i tij është fuqizimi i Njësitit Antikorrupsion për Krime të Rënda të kësaj prokurorie me prokurorë shtesë, ku ka kërkuar nga Kryesuesi Maloku, që kjo kërkesë e tij të gjejë përkrahje brenda Këshillit Prokurorial.

Gjithashtu, Munishi, potencoi se që nga ardhja e tij në krye të kësaj prokurorie ka marrë iniciativë për të caktuar koordinatore shtesë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, konfiskimit dhe sekuestrimit, rastet e drogës, krimeve kibernetike, me qëllim të trajtimit sa më të mirë dhe rritjes së efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve.

Po ashtu, Munishi, deklaroi se nga viti 2020, në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prishtinës ka krijuar Zyrën për ndërmjetësim, e cila ka rezultuar si efikase.

Ndërkaq, Kryesuesi Maloku, tha se do të jetë në shërbim të plotë për të ofruar mbështetjen e nevojshme për kryeprokurorët dhe çdo prokurorë, në mënyrë që të krijohen kushte sa më të mira për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë përkatëse, si dhe ka vlerësuar punën dhe angazhimin e tyre.

Po ashtu, Kryesuesi Maloku, iu ka ofruar mbështetjen e tij dhe të Këshillit Prokurorial dy kryeprokurorëve, me qëllim që këto prokurori t'i arrijnë objektivat e tyre, si dhe të kenë efikasitet më të madh në kryerjen e lëndëve, punëve dhe obligimeve të cilat ata kanë.

Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit dhurojnë gjak

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut organizuan një aksion vullnetar për dhurim të gjakut.



Kësaj iniciative për dhurimin e gjakut iu përgjigjën 18 punëtorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Me këtë rast, përfaqësuesit e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut, shprehu mirënjohje për të gjithë dhuruesit vullnetarë të gjakut të sistemit prokurorial.

Dhurim i gjakut nga punëtorët e sistemit prokurorial ka vazhduar vite me radhë, si një akt i domosdoshëm humanitar për shpëtimin e jetës së njerëzve në vendin tonë.

Fillon draftimi i Rregullore për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Armend Zenelaj, mbajti takimin, në të cilin morën pjesë anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesit e Sekretariatit të KPK-së.



Si pikë e rendit të ditës ka qenë hartimi i draftit të Rregullore për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, qëllimi i së cilës është

përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, pas ndryshimeve të pësuara ligjore.

Ndër të tjera, Komisioni për Çështje Normative kërkoi plotësimin edhe të disa dispozitave të këtij akti, në mënyrë që të harmonizohet me kriteret e transferimit dhe avancimit në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe të caktohet një ditë tjetër për shqyrtimi e këtij akti.

Diskutohet për objektivin e parë të Projektit EUKOJUST

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Veton Shabani dhe Kryetari i Komisionit për Çështje Normative, Armend Zenelaj, kanë mbajtur takim me ekspertin e projektit EUKOJUST, Kristian Turkalj.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i aktiviteteve në kuadër të objektivit të parë të këtij projekti që ka të bëjë me forcimin e kapaciteteve dhe koordinimin ndërinstitucional në sektorin e drejtësisë.



Në këtë takim u diskutua roli dhe kontributi që do të ketë sistemi prokurorial në këtë objektiv dhe ndërveprimi me institucionet e tjera relevante, me qëllim të përfitimit sa më të madh dhe përmbushjes sa më të mirë të projektit.

Zëvendëskryesuesi Shabani, tha se Këshilli Prokurorial është i gatshëm bashkëpunojë dhe të ofrojë kapacitetet e veta me qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta dhe përfitimeve të sistemit prokurorial nga ky projekt.

Në anën tjetër, eksperti Turkalj, shprehu gatishmërinë e tij profesionale për identifikimin e fushave dhe zhvillimin e aktiviteteve që priten të realizohen në kuadër të kësaj objektive.

Bashkëbiseduesit u pajtuan që të koordinojnë punën edhe me ekspertët e tjerë që do të jenë të përfshirë në objektivin për forcimi i kapaciteteve dhe koordinimin ndërinstitucional në sektorin e drejtësisë të projektit EUKOJUST.

Diskutohet kërkesa buxhetore për vitin 2022

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, i udhëhequr nga Ariana Shajkocvi, kryesuese, mbajti takimin e radhës, në të cilin është diskutuar kërkesa buxhetore e sistemit prokurorial për vitin 2022 dhe vlerësimet e hershme 2023-2024.



Në takim u diskutuan kërkesat e prokurorive dhe programeve buxhetore, në veçanti, kërkesat për rritjen e numrit të prokurorëve dhe nëpunësve civilë, rritjen e buxhetit në kategorinë e pagave, mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve.

Komisioni propozoi disa ndryshime në kërkesën për rritjen e pozitave.

Deklaratë e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përmes kësaj deklaratë siguron opinionin publik se Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka mbështetjen e plotë të të gjithë anëtarëve të Këshillit në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues dhe ligjor.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, në vazhdimësi është vlerësuar maksimalisht për punën e tij sipas standardeve më të larta nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Andaj do të dështojë çfarëdo tendence për inskenime të mundshme që kanë për qëllim destabilizimin institucional, cenimin e integritetit, mandatit dhe prestigjit të Kryeprokurorit të Shtetit.



Këshilli Prokurorial i Kosovës, si organ Kushtetues i pavarur dhe i paanshëm, nuk do të lejojë asnjë interferim apo çfarëdo interesi nga jashtë, përfshirë edhe dëshirat e partive politike, individëve të caktuar dhe grupeve të interesit që të ndikojnë në punën dhe mandatin e bartësve të sistemit prokurorial, përkatësisht të Kryeprokurorit të Shtetit.

Mbahet takimi koordinues me partnerët dhe donatorët e sistemit prokurorial

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Jetish Maloku, mbajti një takim koordinues me përfaqësues të ambasadave të vendeve të ndryshme në Kosovë, përfaqësues të Bashkimit Evropian, përfaqësues të institucioneve vendore, përfaqësues të organizatave dhe projekteve të ndryshme, të cilat mbështesin sistemin prokurorial në Kosovë.



Rrjedhimisht, gjatë takimit u prezantuan projektetpropozimet kryesore, të identifikuara në procesin e punës, për të cilat nevojitet mbështetja e partnerëve dhe donatorëve të sistemit prokurorial.

Po ashtu, u diskutuan mundësitë e mbështetjes së objektivave për fuqizimin dhe avancimin e këtij sistemi, me ç'rast, Kryesuesi Maloku, fillimisht, falënderoi për kontributin e madh të donatorëve në të kaluarën, si dhe i njoftoi të pranishmit në formë të përmbledhur për zhvillimet kryesore në sistemin prokurorial, duke u fokusuar kryesisht në objektivat e rëndësishme strategjike, duke theksuar nevojën e madhe të mbështetjes së mëtejshme nga ana e donatorëve, ashtu siç është vepruar deri më tani. "Bashkëpunimi dhe mbështetja që kemi marrë nga ju ka qenë dhe është indikator mjaft i fuqishëm për rezultatet e arritura në sistemin prokurorial. Përfitimi nga përvojat dhe ekspertiza juaj është e pazëvendësueshme", ka thënë Maloku.

Në vijim të takimit, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, Valdrin Krasniqi, prezantoi pikat kyçe të nevojave të sistemit prokurorial, ku do të fokusohet bashkëpunimi i përbashkët në të ardhmen, pika këto, të cilat janë përgatitur në formë të projektpropozimeve, në të cilat janë përcaktuar

qartazi objektivat specifike, rezultatet e pritshme, aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe përfitimet që do të ketë sistemi prokurorial.

Përfaqësuesit e donatorëve, thanë se ky takim i KPK-së për koordinimin e donatorëve është jashtëzakonisht i qëlluar, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të vazhduar mbështetjen e tyre, si dhe për të krijuar parakushte për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë.

Sikurse edhe herëve të kaluara, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit synojnë që me anë të realizimit të mbështetjes së donatorëve të fuqizojnë kriteret, vlerat dhe standardet më të larta të punës, kurse projektet e propozuara për mbështetje kanë të bëjnë me sistemin e digjitalizimit të procesit të punës, infrastrukturën, ngritjen e besimit publik në sistemin prokurorial, ngritjen e kapaciteteve të komisioneve të Këshillit dhe stafit, avancimin e infrastrukturës fizike, sistemit të sigurisë dhe teknologjisë informative.

Mbahet punëtori për draftimin e Rregullore për SMIL-in

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i mbështetur nga Projekti i BE-së, EUKOJUST, organizoi një punëtori dyditore për draftimin e Rregullore për menaxhimin e procesit të punës përmes sistemit elektronik, SMIL, në sistemin prokurorial.

Në fjalën hyrëse të kësaj punëtorie, Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, tha se Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka prioritet të lartë SMIL-in, të cilin e ka vendosur si objektiv të veçantë në Planin strategjik të Këshillit dhe në dokumentet e tjera relevante të sistemit prokurorial.

Kryesuesi Maloku, me tej, tha se me draftimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje, përpos që planifikohet të përcaktohet mënyra e menaxhimit të procesit të punës, në të njëjtën kohë, ky akt do të ndikojë edhe në unifikimin e të gjitha procedurave dhe ngritjen e efikasitetit të punës. Me këtë rast, ai shprehu falënderimin e tij për Projektin EUKOJUST lidhur me mbështetjen financiare për organizimin e kësaj punëtorie dhe aktivitetet e tjera në fushën e teknologjisë informative.



Ndërsa, Kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative të KPK-së, prokurori Armend Zenelaj, tha se kjo punëtori do të rezultojë me një draft të mirë të kësaj rregulloreje.

Kjo punëtori është përshëndetur edhe nga përfaqësuesi i Projektit EUKOJUST, Arben Isufi.

Në këtë punëtori morën pjesë Kryesuesi i KPK-së, anëtarë të komisioneve të përhershme të KPK-së, kryeprokurorë, prokurorë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtar

Diskutohen aktivitetet e Projektit të Drejtësisë të USAID-it

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, priti në takim udhëheqësen e Projektit të Drejtësisë të USAID-it në Kosovë, GERALYN BUSNARDO.



Gjatë këtij takimi, udhëheqësen e Projektit, znj. Busnardo, i prezantoi Kryesuesit Maloku aktivitetet që po ndërmerren në kuadër të realizimit të objektivave të Projektit të Drejtësisë. Ky projekt ka për qëllim aplikimin e qasjes në drejtësi të përqendruar te njerëzit për të përmirësuar kapacitetin institucional që të sigurojë njerëzve qasje në shërbime cilësore dhe mjete të shumëllojshme për të zgjidhur nevojat e tyre të drejtësisë dhe problemet ligjore të përditshme dhe për të gjeneruar besim më të madh të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sundim të ligjit.

Në anën tjetër, Kryesuesi Maloku, shprehu gatishmërinë që ky projekt të vazhdojë aktivitetet e veta edhe në prokuroritë e Republikës së Kosovës, me qëllimin kryesor të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të qasjes sa më të lehtë të publikut në shërbimet prokuroriale.

Bashkëbiseduesit u pajtuan që takimet lidhur me këtë projekt të vazhdojnë në drejtim të planifikimit për aktivitetet e radhës.

Nënshkruhet memorandum mirëkuptimi në mes të KPK-së, organizatave përfaqësuese të shoqërisë civile dhe komunitetit të gazetarëve

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve dhe objektivave strategjike për ngritjen e besueshmërisë dhe fuqizimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës, Jetish Maloku, ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit në mes të KPK-së dhe organizatave përfaqësuese të shoqërisë civile dhe të komunitetit të gazetarëve, CIVIKOS dhe KMSHK.



Qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumi është ndërtimi i standardeve të komunikimit në mes të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit me shoqërinë civile dhe mediat, duke respektuar legjislacionin penal, Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, Ligjin për Sinjalizuesit dhe ligjet e tjera.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Maloku, gjatë ceremonisë së organizuar me këtë rast, tha se me këtë memorandum synohet ndërtimi i kapaciteteve dhe i rrugëve të komunikimit për raportimin e rasteve të veprave penale të Prokurorit të Shtetit, të identifikuar nga shoqëria civile dhe mediat, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e raportimeve dhe informacioneve që dërgohen në Prokurorinë e Shtetit, duke ndihmuar kështu në përfitimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Ndërkaq, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit të gazetarëve, u shprehën të kënaqur me rastin e nënshkrimit të këtij memorandumi, me ç'rast potencuan se presin të bëhet intensifikimi i ndërveprimeve të përbashkëta të bashkëpunimit, duke mënjanuar vështirësitë eventuale ndërkombëdore. Ata thanë se ky akt i hapë rrugë dialogut të strukturuar dhe ngritjes së besueshmërisë së publikut në punën e sistemit prokurorial, me anë të të prezantimit dhe publikimit transparent të kësaj pune nga ana e shoqërisë civile dhe gazetarëve.

Po ashtu, ky memorandum është përkrahur në mënyrë të veçantë edhe nga përfaqësuesit e USAID-it, si një ndër mbështetësit kryesorë të sistemit të drejtësisë në Kosovë, të cilët theksuan se do t'i mbështesin iniciativat e përbashkëta në mes të sistemit prokurorial, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit të gazetarëve.

Në kuadër të nënshkrimit të këtij memorandumi është hartuar një formular bazik për mënyrën e raportimit të rasteve në prokurori, ku tregohet se si të emërtohen rastet e paraqitura nga mediat dhe shoqëria civile.

Telegram urimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës drejtuar Kryetares së Gjykatës Kushtetuese me rastin e marrjes së detyrës

Në këtë telegram urimi thuhet:

E nderuara Znj Caka-Nimani,

Në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në emrin tim personal, dëshiroj t'ju shpreh urimet më të sinqerta me rastin e marrjes së detyrës tuaj - Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Me këtë rast, shpreh besimin tim të plotë se me përkushtim dhe devotshmëri të madhe do të arrini të dërgoni më tej të arriturat e këtij institucioni të lartë shtetëror, duke kontribuar në mbrojtjen e vlerave më sublime të drejtësisë në vendit tonë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës mirëpret bashkëpunimin e ndërsjellë institucional për fuqizimin e mëtejme të sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë në Republikën e Kosovës.

E nderuara Kryetare, së bashku me urimet e mia dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës për suksese në detyrën tuaj të re, gjithashtu, ju shpreh edhe konsideratën time më të lartë.

Sinqerisht,

Jetish Maloku,

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Mbahet takimi i 200-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, mbajti takimin e 200-të me radhë.

Në fillim të këtij takimi, Këshilli ka themeluar Panelin hetimor për rastin e një prokurori të Prokurorisë

Themelore në Pejë, në përbërje: Kujtim Munishi, kryesues dhe Nijazi Rexha dhe Bogdan Spadijer, anëtarë, ndërsa anëtarë rezervë u zgjodhën prokuroret Drita Hajdari dhe Natasha Tanic.



Këshilli, gjatë këtij takimi, ka diskutuar për kërkesën e Odës së Avokatëve të Kosovës për ndryshimin e tarifave për kompensimin e avokatëve, me ç'rast ka autorizuar komisionet e përhershme të shqyrtojnë kërkesat dhe të dalin me rekomandime për gjetjen e një zgjidhjeje.

Po në këtë takim, anëtarët e KPK-së kanë miratuar kërkesën e U.D.Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit, Valdrin Krasniqi, për harmonizimin e praktikave të proceseve të rekrutimit me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Pikë tjetër e shqyrtuar në këtë takim ishte edhe Raporti i Komisionit për Transferim dhe Avancim në procesin e avancimit të një pozite në Prokurorinë Themelore të Prishtinës. Me këtë rast, Këshilli ka miratuar Raportin e Komisionit të lartcekur me rekomandimin që prokurori Zejnullah Gashi të avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore të Prishtinës.

Në vazhdim është mbajtur seanca dëgjimore për një rast disiplinor ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial gjatë këtij takimi ka trajtuar edhe disa pika të tjera që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e tij.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Në muajin qershor 2021, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka shqyrtuar Raportin financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2020. Këtë raport të KPK-së e kanë prezantuar anëtarë të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, prokurori Haki Gecaj dhe Ushtuesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit, Valdrin Krasniqi.

Lidhur me këtë raport, por edhe Raportin e Auditorit Kombëtar, i cili nuk ka asnjë të gjetur për KPK-në, deputetet anëtarë të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere kanë shprehur vlerësimin e tyre, ndërsa kryesuesi i këtij Komisioni, Armend Muja, duke përgëzuar punën e KPK-së sa i përket dy raporteve të lartcekura ka kërkuar me mirëkuptim që raporti i KPK-së të merret si shembull dhe të prezantohet në institucionet e tjera të pavarura.

Në muajin qershor është bërë një vizitë në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe Prokurorinë e Apelit, si dhe në ZMNV në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe janë përgatitur informata për prezantim në Nënkomitetin për Drejtësi, Liri dhe Siguri, duke ofruar komente në konkluzionet e takimeve të këtij mekanizmi.

Në vijim, po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe administrative janë realizuar disa punëtori dhe trajnime, përfshirë: Punëtorinë me përfaqësuesit e OPDAT-in nga Ambasada e Amerikës për vlerësimin e performancës së prokurorëve nga ana e Komisionit dhe eprorëve, trajnimi profesional në fushën e sigurisë së TI nga stafit i Divizionit për Infrastrukturë; dy trajnimet në fushën e komunikimit: i pari, me titull: “Menaxhimi i ndryshimit” dhe, i dyti, “Protokolli i medias”, si dhe trajnimi “Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale”.

Në bashkëfinansim me Projektin EukoJust është mbajtur punëtorja për draftimin e Rregullores për menaxhimin e procesit të punës përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në sistemin prokurorial të Kosovës.

Gjithashtu është realizuar një takim pune me përfaqësuesit e OSBE-së lidhur me mundësitë e ofrimit të mbështetjes së këtij institucioni ndërkombëtar ndaj Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe me përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë për krijimin e mekanizmit për realizimin e trajnimeve të detyrueshme të prokurorëve, si pasojë e vlerësimit “pamjaftueshëm” nga KVPP-ja, të miratuara në KPK-ja.

Nga ana tjetër, është përgatitur dhe dërguar kërkesa për rishikim buxhetor për vitin 2021 dhe në proces sipër është përgatitja e kërkesës buxhetore për vitin 2022-2024 dhe është përgatitur Raporti i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm për Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe është përgatitur drafti i parë i Procedurës Standarde të Operimit për ofrimin e shërbimeve duke

shfrytëzuar sistemet elektronike në sistemin prokurorial.

Në bazë të vlerësimeve është përgatitur një kërkesë për Ministrinë e Jashtme të Norvegjisë për mbështetje financiare për mirëmbajtjen dhe avancimin e SMIL-it për prokurori dhe gjykatë, si dhe është përgatitur raporti për Grupin punues të përdorueseve, i cili paraqet sfidat gjatë zbatimit të SMIL në prokurori dhe gjykata.

Janë adresuar komentet e Komisionit Evropian në Planin e veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane - ERA 2 dhe është mbajtur takim në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me përgatitjen e raporteve të vlerësimit të sistemit të drejtësisë bazuar në metodologjinë CEPEJ të Këshillit të Evropës.

Ndërkohë është ofruar mbështetje në përgatitjen e komenteve të sistemit prokurorial në draftin e koncept dokumentit për vetingun dhe janë identifikuar ndryshimet e bëra në Projektligjin për ndryshim të Ligjit të buxhetit 2021 dhe është përgatitur draftshkresa për Kuvend.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është bartja e të gjitha dosjeve elektronike të prokurorëve nga sistemi i vjetër në sistemin e ri elektronik dhe funksionalizimi i modulit të disiplinimit, si dhe përgatitja e Pyetësorit të kontrollit të brendshëm për buxhet dhe financa.

Në kuadër të bashkëpunimit me mekanizmat e jashtëm mbështetës janë përgatitur projektpropozimet për prezantim në takimin koordinues me donatorët dhe partnerët e sistemit prokurorial.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në qershor nga ana e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, veçojmë:

Aktivitetet e Zyrës për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial kanë qenë të përqendruara në hartimin e Raportit analitik për rastet e dhunës në familje për periudhën 2019-2020 dhe TM-1 të vitit 2021, hartimin e Raportit për lëndët e bartura (trashëguara) për periudhën 2018-2020, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për hartimin e Raportit për përmbushjen e normës orientuese të prokurorive dhe prokurorëve për periudhën janar-qershor 2021, mbështetjen e procesit të rekrutimit, transferimeve dhe avancimeve të prokurorëve përmes zyrtarit të caktuar për realizimin e këtyre proceseve, kontrollimin e shënimeve lidhur me procesin bartjes

nga versioni i aktual në versionin e ri të bazës së të dhënave SEMDP, në përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në dosjet e prokurorëve, pjesëmarrjen në takimet e Grupit punues për reformën në administratën e sistemit prokurorial, përgatitjen e informatave në kompetencë të ZMAVP-së për mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial në mbështetje të proceseve të punës në zhvillim, si dhe angazhime të tjera për në përmbushje të obligimeve ligjore në kuadër të ZMAVP.

Ndërkaq, aktivitetet e Zyrës për Statistika (ZS) kanë vijuar me anë të grumbullimit të të dhënave statistikore dhe përpilimit të pasqyrave për ngarkesën dhe efikasitetin e prokurorëve në zgjidhjen e lëndëve nga regjistrat: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN, për secilin prokuror veç e veç; grumbullimin e të dhënave statistikore dhe gjendjen e rasteve në prokurori sipas departamenteve dhe llojeve të regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN; grumbullimin e të dhënave statistikore dhe gjendjen e rasteve në prokurori për rastet karakteristike nga Mekanizmi përcjellës për harmonizimin e shënimeve statistikore sipas grupeve të veprave penale: armët, narkotikët-drogat, krimin e organizuar, korrupsionin, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e migrantëve, shpëlarje parash, krime ekonomike dhe nxitje dhe urrejtje nga Neni 147 i KPK-së, sipas dhe llojeve të regjistrave: PP dhe PPN; parapërgatitjen për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për raportet statistikore për TM-II dhe Raportin gjashtëmujor për vitin 2021 për rastet penale me kryes madhorë (PP), kryes të mitur (PPM), kryes të panjohur (PPP) dhe informatat apo rastet e ndryshme penale, me të cilat pretendohet se janë kryer veprat penale (PPN), ndihma juridike ndërkombëtare (NJJN), rastet për të cilat aplikohen procedurat alternative, rastet e Prokurorisë së Apelit, rastet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, raportet statistikore për rastet që kanë të bëjnë me raportimet për integritet evropiane dhe raportet statistikore për MSA. Kjo zyrë ka përgatitur edhe forma të reja për grumbullimin e të dhënave të veçanta statistikore, sipas kërkesës së Ambasadës së SHBA-së për DASH-in. Këto të dhëna në të ardhmen do të grumbullohen rregullisht dhe do të jenë pjesë e raporteve të rregullta periodike. Gjithashtu janë përgatitur format për grumbullimin e të dhënave për 12 prokurorë, të cilët i nënshtrohen procesit të vlerësimit, të cilëve iu janë dërguar format dhe iu është caktuar afati për raportimin e të dhënave të kërkuara, si dhe ka përgatitur informata dhe raporte të ndryshme statistikore sipas kërkesës së Zyrës për Komunikim

Publik në KPK dhe komunitetit akademik - kandidatëve për Baçelor dhe Master.

Rrjedhimisht, aktivitetet e Zyrës për Trajnime shënojnë zhvillime mjaft dinamike në fushën e trajnimeve profesionale, në të cilat marrin pjesë prokurorët dhe stafi administrativ, ndër të cilat veçojmë: Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ – Projektin për reformat ligjore dhe administrative, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin “Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtjen nga dhuna në familje” dhe në bashkëpunim me IRZ-në ka realizuar trajnimin “Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar, sesioni II”.

Gjithashtu, trajnime të tjera janë realizuar për veprat penale kundër integriteti seksual të fëmijëve, pastaj trajnimi për provat në procedurë penale dhe ligjshmërinë e tyre, për menaxhimin e rasteve, si dhe në bashkëpunim me projektin e JUFREX-it “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore për lirinë e medias në Evropën Juglindore”, është realizuar trajnimin për mbrojtjen e gazetarëve.

“E drejta e mbrojtjen së pronës - Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së ”, ishte tema e një trajnimi online, i mbajtur përmes platformës zoom dhe “Veprat penale kundër martesës dhe familje”, si dhe në bashkëpunim me UNDP-në, është mbajtur trajnimi i specializuar për krimin kibernetik.

Gjithashtu është organizuar trajnimi për kornizën legjislativë në fushën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe ai për menaxhimin i dosjeve dhe lëndëve në sistemin prokurorial.

Risite në kompetenca dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin gjyqësor, shkrimi dhe arsyetimi ligjor - stafi i gjykatave dhe prokurorive, ishin në fokus të trajnimeve të radhës, që janë zhvilluar në muajin qershor 2021.

